

Thirrje për aplikim në Programin e Profesionistëve të Rinj

Objektivi i projektit “Iniciativa për Qëndrueshmëri Ekonomike Rurale” (RESI), është të promovoj konkurrueshmërinë e fermerëve, prodhuesve bujqësor dhe kompanive për përpunimin e ushqimit me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës rural, krijimit të vendeve të punës dhe gjenerimit të të hyrave në komunat e targetuara: Prishtinë, Novobërdë, Kamenicë dhe Ranillugut. Programi i profesionistëve të rinj është i bashkë-financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe komunat përkatëse të targetuara ne projekt: Prishtinë, Novobërdë, Kamenicë dhe Ranillug.

Qëllimi i kësaj Thirrje për Aplikim është që përmes 15 profesionistëve të rinj (PR) të fuqizoj kapacitetet dhe zhvillimin organizativ të Departamenteve Bujqësore dhe Ekonomike të komunave të targetuara. Aktivitetet e PR do të përfshijnë zbatimin e skemës së nën-granteve, ofrimin e njohurive teknike në fushën e bujqësisë, mbështetjen për përfshirjen socio-ekonomike dhe fuqizimin ekonomik të grave. PR-të do të vendosen në kuadër të ekipit të projektit të RESI-t si dhe në komunat e targetuara ku do të përfitojnë nga skema gjithëpërfshirëse e trajnimeve që do të ofrohen nga projekti. Kriteret e pranueshmërisë dhe përzgjedhjes janë si më poshtë:

- Të jenë nën 35 vjet, të sapo diplomuar nga fakulteti në fushat e ekonomisë, bujqësisë, teknologjisë ushqimore dhe fushave të ngjashme;
- Të papunësuar dhe pa përvojë të mëhershme të punës;
- Të kenë shkathtësi kompjuterike në aplikacionet e Microsoft;
- Të njohin gjuhën angleze;
- Të kenë shkathtësi të mira komunikimi, lidhshipi, negociimi, dhe interpersonale;

Termet e Referencës (TeR) për aplikantët dhe dokumentet e tjera të nevojshme do të jenë në dispozicion online nga data 2 Shkurt, 2017 në uebfaqen e projektit www.resi-ks.org. Aplikacionet duhet të dorëzohen me e-mail në info@resi-ks.org, nga 2 deri më 17 shkurt 2017.

Prandaj, projekti CARE/RESI i fton të gjithë të diplomuarit e fakultetit në fushën e ekonomisë, bujqësisë, teknologjisë së ushqimit dhe fushave të ngjashme në komunat e sipërpërmendura të marrin pjesë në seancën informuese që do të mbahet në lidhje me këtë thirrje për aplikim.

#	Komuna	Vendi	Data
1	Prishtinë	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë , salla kryesore	07 Shkurt 2017 në ora 11:00